



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

V E N D I M

Nr.11 Datë: 22.07.2021

“PËR MIRATIMIN E PJESËMARRJES NË GRUPET E PUNËS DHE NË KOMISIONET PËR VLERËSIMIT E FIGURAVE, TË SPECIALISTËVE TË JASHTËM PËR KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 22.07.2021, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe buxhetit **“PËR MIRATIMIN E PJESËMARRJES NË GRUPET E PUNËS DHE NË KOMISIONET PËR VLERËSIMIT E FIGURAVE, TË SPECIALISTËVE TË JASHTËM PËR KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR** , bazuar në nenin 77/ç të Ligjit nr. 139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, Ligjin nr.137/2020, *“Per Buxhetin e Vitit 2021”*, nenin 5/ç të Ligjit nr. 10405 datë 24.3.2011 *“Per kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”*, Ligjit Nr. 112/2014 *“Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”* si dhe në VKM-në Nr. 861, datë 10.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”*, në Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”* (i ndryshuar), në VKM-në Nr. 429, datë 12.09.2002 *“Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore”*, ligjit Nr. 109/2018 *“Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”*, neni 8, Dokumentet për shpalljen ose njohjen e statusit *“Dëshmor i Atdheut”*, VKQ Shkoder nr.16, datë 30.12.2020 *“Mbi miratimin e buxhetit të vitit 2021”*, , Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj. Bazuar në Aktin Normativ Nr.03 datë: 15.03.2020 konkretisht neni 5, *“për vendimarrjen e organeve kolegjiale gjatë gjendjes së infeksionit Covid-19”*, si dhe bazuar në Urdhërin Nr.80 datë 17.11.2020 *“për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19...”*

në funksion të realizimit të përgjegjësisë ligjore të administratës të KQSH-së, për arsye të numrit të reduktuar të personelit administrativ të tij

Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, mbledhja e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua online nëpërmjet platformës Zoom, , pas relatimit nga zyra e drejtorisë së financës dhe buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **11 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim.**
Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

V E N D O S I :



1. Miratimin e Grupit të Punës, të përberë nga specialistë të jashtëm, të angazhuar në Njësinë e Prokurimit dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, me këtë përbërje;
 - Inxhinier hidroteknik – anëtar i Njësisë së Prokurimit;
 - Inxhinier elektrik – anëtar i Njësisë së Prokurimit;
 - Inxhinier mekanik – anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
 - Inxhinier elektrik – anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
 - Inxhinier hidroteknik – anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

2. Miratimin e shpërblimit të specialistëve të jashtëm, të angazhuar në Njësinë e Prokurimit dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, në masën 10,000 (dhjetëmijë) lekë, për çdo pjesëmarrje në procedurë prokurimi.

3. Miratimin e specialistëve të jashtëm, shtesë në komisionin e vlerësimit të figurave, si më poshtë;
 - 2(dy) specialistë për dhënien e titujve vendore të nderit,
 - 2(dy) specialistë për shtesa për pension të veçantë
 - 2(dy) specialistë për njohjen e statusit për dëshmorin e atdheut,

4. Miratimin e shpërblimit të specialistëve të jashtëm, shtesë në komisionin e vlerësimit të figurave në masën 7,000 (shtatëmijë) lekë, për çdo pjesëmarrje në vlerësim.
5. Burimi i Financimit do të jetë Transferta e Pakushtëzuar e vitit 2021 e planifikuar në Art. 602 .
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI

Hilmi LAKTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

RELACION

“PËR MIRATIMIN E PJESËMARRJES NË GRUPET E PUNËS DHE NË KOMISIONET PËR VLERËSIMIT E FIGURAVE, TË SPECIALISTËVE TË JASHTËM PËR KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR”

Bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Marrëveshjen Nr.22693 prot. datë 30.12.2019 për bashkëpunimin e Bashkisë Shkodër me Këshillin e Qarkut në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, Marrëveshjen Nr. 2560 Prot. datë 09.10.2020 “Për bashkëpunim financiar në fushën e shërbimit të furnizimit me ujë dhe ujësjellës kanalizimeve për kryerjen e investimit “Ndërtim i Ujësjellësit Muriqan, Bashkia Shkodër” ndërmjet AKUM-it dhe KQSH-së, Vendimin e KQSH-së Nr.16, datë 30.12.2020 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimar 2021-2023”, si dhe shkresën nr. 340 prot. datë 12.02.2021 “Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2021-2023 për shpenzime kapitale “Furnizimi me ujë dhe kanalizime” të AKUM-it;

→ Këshilli i Qarkut Shkodër duhet të realizojë sa më parë procedurën elektronike të prokurimit për ndërtimin e Ujësjellësit në fshatin Muriqan, në Bashkinë Shkodër;

Por, në kushtet e shkurtimit të personelit administrativ të Këshillit të Qarkut Shkodër në fillim të vitit 2016, është shumë i nevojshëm angazhimi i specialistëve të jashtëm, përkatësisht të inxhinierëve në fusha të ndryshme, sepse aktualisht institucioni ka vetëm një inxhinier ndërtimi.

Për këtë qëllim, legjislacioni ka përcaktuar një sërë dispozitash ligjore, konkretisht:

- Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 75, pika 3 (fjalë e fundit), citohet: “Në rastin e mundësisë së personelit, autoriteti/enti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.”
- E drejta e Autoritetit Kontraktor për të caktuar ekspertë të jashtëm, përcaktohet jo vetëm për përbërjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, por edhe për përbërjen e Njesisë së Prokurimit, përkatësisht në pikën 2 (fjalë e parafundit) të nenit 74 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” citohet: “Në rast mundësie të personelit, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete/ente kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm.”
- Përcaktimi i kompetencave të Këshillit të Qarkut Shkodër për mënyrën e shpërblimit të punonjësve apo personave të tjerë, të zgjedhur apo të emëruar, përcaktohet në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përkatësisht në nenin 77, shkronja “ç”, përcaktohet se: Këshilli i Qarkut Shkodër “miraton strukturën, organikën dhe kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës të qarkut, të njësive të institucioneve buxhetore në varësi të qarkut, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të

punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

→ E drejta e Këshillit të Qarkut Shkodër për caktimin e pagave dhe shpërblimeve përcaktohet edhe në ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, përkatësisht në nenin 5, shkronja “ç” të këtij ligji, citohet: Këshilli i Qarkut Shkodër miraton: *“shpërblime të personave, nga burimet e veta financiare, të cilët caktohen në komitete, borde, këshilla, komisione, e të tjera të kësaj natyre, që ngrihen me vendim të këshillit përkatës”.*

Referuar dispozitave të sipërcituara, në funksion të përcaktimit të shpërblimeve të ekspertëve/specialistëve të jashtëm në kryerjen e detyrave e të rëndësishme me përgjegjësi të lartë për prokurimin e fondeve publike, propozojmë të miratohet nga Këshilli i Qarkut Shkodër, **Grupi i Punës, që bashkëpunon me Njësinë e Prokurimit dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, me këtë përbërje;**

Inxhinier hidroteknik – anëtar i Njësisë së Prokurimit;

Inxhinier elektrik – anëtar i Njësisë së Prokurimit;

Inxhinier mekanik – anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

Inxhinier elektrik – anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

Inxhinier hidroteknik – anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Duke marrë parasysh, afatin kohor të angazhimit të specialistëve të fushës (inxhinierë), që përcaktohet në varësi të ecurisë së procedurave të prokurimit, që mund të zgjasin nga 15 ditë në disa muaj;

Duke marrë parasysh përgjegjësinë e lartë, si dhe volumin e punës të ofrimit të ekspertizës së tyre, brenda mundësive të buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër, propozojmë të caktohet një shpërblim në masën **10,000(dhjetëmijë) lekë**, për çdo pjesëmarrje në procedurë prokurimi.

Këshilli i Qarkut Shkodër, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, pika ll, , Ligjit Nr. 112/2014 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë” si dhe në VKM-në Nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”, në Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), në VKM-në Nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore”, ligjit Nr. 109/2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 8, Dokumentet për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”, Rregullores se miratuar nga këshilli i qarkut Shkodër me vendimin nr.03 datë 26.03.2020, përcakton procedurat për trajtimin e personave që janë subjekt i ligjeve të mësipërme nga Këshilli i Qarkut Shkodër, Duke marrë në konsideratë për sa parashikon legjislacioni i mësipërm si dhe zhvillimet pozitive në fusha të caktuara në qarkun e Shkodrës, ku individë të caktuar kanë dhënë kontribute të veçanta, ndaj Këshilli i Qarkut nderon sipas rastit, çdo personalitet shqiptar ose të huaj për veprimtari të shquar, në dobi të Qarkut Shkodër apo për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të tij.

Duke patur parasysh që sipas legjislacionit përcaktohet qartë se këshilli i qarkut ka kompetencën që të krijojë një komision këshillimor, që funksionon mbi procedurat për trajtimin e kërkesave të ndryshme të ardhura në adresë të këtij Këshilli, për dhënien e titujve vendore të nderit, është menduar bazuar dhe në vendimet përkatëse ligjore që, Komisioni Këshillimor të përbëhet nga të gjithë anëtarët e komisionit Juridik të vlerësimit të figurave dhe shqyrtimit të kërkesave për pensione të veçanta shtetërore dhe atyre për njohjen e statusit të dëshmorit të atdheut të Këshillit të Qarkut Shkodër, të angazhohen **për secilin rast** nga 2 (dy) anëtarë personalitete të jashtme, që

përzgjidhen mes njerëzve të shquar dhe që kanë dhënë kontribut në fushën përkatëse, për të ruajtur nivelin korrekt, pa-anësinë, transparencën, në procedurat e vlerësimit ndaj rasteve që paraqiten, por duke respektuar dhe rekomandimet që rrjedhin nga aktet nënligjore përkatëse.

Pas miratimit të këtij vendimi do të kalohet në nxjerrjen e Urdhrit të përvitshëm për formimin dhe funksionimin e komisionit këshillimor për procedurat e vlerësimit;

→ për dhënien e titujve vendore të nderit,

→ shtesave për pension të veçantë

→ njohjen e statusit për dëshmorin e atdheut,

në qarkun e Shkodrës, si dhe të përcaktohet vlera e shpërblimit për kontributin dhe pjesëmarrjen e tyre në këtë komision e cila do të jetë në masën 7,000 leke për pjesëmarrje në vlerësim.

Grupi i punes:

Andrea Jakova

Gjyljana Miruku

Kozeta Vuksanlekaj

